



BASHKITË PËR NË EVROPË
Një projekt i financuar nga BE

RRUGËTIM NË PROGRAMIN CERV

**Qytetarët, Barazia, të
Drejtat dhe Vlerat**

**SI PËRFITOJNË
BASHKITË?**

Rrugëtim në Programin CERV - Qytetarët, Barazia, të Drejtat dhe Vlerat

Si përfitojnë Bashkitë

Parathënie

Kjo Broshurë Orientuese është përgatitur në kuadër të Projektit 'Bashkitë për në Evropë' 2.0 për të ndihmuar bashkitë kur shpallen thirrjet për propozime nën Programin Evropian CERV (*Citizens, Equality, Rights and Values- Qytetarët, Barazia, të Drejtat dhe Vlerat*) 2021-2027 – pasues i Programit Evropa për Qytetarët 2014-2020.

Broshura vjen si një përmbledhje e praktikës 7-vjecare që ekipi i Projektit ka pasur në ndihmë të bashkive nën thirrjet e hapura të Programit (aktualit dhe atij të mëparshëm) – kryesisht ato ku bashkitë mund të aplikojnë, Binjakëzimi i Qyteteve/Rrjetëzimi i Qyteteve/Kujtesa Historike, duke i asistuar ato me trajnime dhe mentorim hap pas hapi për të shkruar një projekt të suksesshëm.

Broshura përmban ndërmjet të tjerave:

- Prezantim i shkurtër programit CERV dhe cfarë ofron për bashkitë
- Si të gjejnë partnerë
- PIC – si ta aksesojnë dhe orientim për tu regjistruar/rimarrë/rifresktuar
- Si të aplikojnë në portal
- Histori suksesi

Suksese!

Pergatiti: Ana Mullanji
Email: anadervishi@yahoo.com

Pëmbajtja

1. ÇFARË ËSHTË PROGRAMI CERV?

2. GRANTE DHE THIRRJE PËR PROJEKT-PROPOZIME

- 2.1. Thirrje për propozime për të promovuar ndërgjegjësimin e organizatave të shoqërisë civile, ndërtimin e kapaciteteve dhe zbatimin e Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së
- 2.2. Thirrje për propozime për të promovuar barazinë dhe për të luftuar racizmin, ksenofobinë dhe të gjitha format e tjera të diskriminimit
- 2.3. Thirrje për propozime mbi kujtesën Evropiane
- 2.4. Thirrje për propozime për të nxitur angazhimin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve
- 2.5. Thirrje mbi të drejtat e fëmijës dhe pjesëmarrjen e fëmijëve
- 2.6. Thirrje për propozime për Binjakëzim Qytetesh
- 2.7. Thirrje për propozime për Rrjetëzim të Qyteteve
- 2.8. Thirrje për propozime për të parandaluar dhe luftuar dhunën ndaj grave dhe dhunën ndaj fëmijëve

3. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR TË BËRË NJË APLIKIM

4. REGJISTRIMI I BASHKISË NË PORTALIN “FINANCIMET DHE TENDERAT”

- 4.1 Si të kontrolloni nëse Bashkia/Organizata juaj ka një numër PIC
- 4.2 Si të merrni numrin PIC (Participant Identification Code)
- 4.3 Regjistroni bashkinë/organizatën tuaj
- 4.4 Çfarë të bëni nëse keni dy numra PIC

5. KU TË GJEJMË PARTNERË DHE MODELI I THIRRJES PËR PARTNERË

6. SI TË DORËZONI NJË APLIKIM

7. SHEMBUJ FRYMËZUES

1. ÇFARË ËSHTË PROGRAMI CERV?

Programi Qytetarët, Barazia, të Drejtat dhe Vlerat (Citizens, Equality, Rights and Values- CERV) është program i Bashkimit Evropian i cili u lançua në vitin 2021 dhe do të zgjasë për shtatë vjet, deri në vitin 2027. Ai u krijua së bashku me programin e Drejtësisë 2021-2027, nën Fondin e Drejtësisë, të Drejtave dhe Vlerave.

Programi CERV- Qytetarët, Barazia, të Drejtat dhe Vlerat siguron mbështetje dhe financim për angazhimin qytetar, barazinë për të gjithë dhe zbatimin e të drejtave dhe vlerave të BE-së.

Programi CERV promovon shkëmbimet midis qytetarëve nga vende, kultura, gjini dhe prejardhje të ndryshme socio-ekonomike, forcon mirëkuptimin e ndërsjellë dhe tolerancën dhe u jep mundësinë të zgjerojnë perspektivat dhe të zhvillojnë ndjenjën e përkatësisë dhe identitetit Evropian përmes binjakëzimit të qyteteve dhe rrjeteve të qyteteve.

Qëllimi i këtij programi është të mbrojtë dhe promovojë të drejtat dhe vlerat e mishëruara në Traktatet e BE-së dhe Kartën e të Drejtave Themelore, veçanërisht duke mbështetur organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në nivel lokal, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

Programi CERV synon të mbështesë dhe të zhvillojë shoqëri të hapura, të bazuara në të drejta, demokratike, të barabarta dhe gjithëpërfshirëse, bazuar në sundimin e ligjit. Kjo përfshin një shoqëri civile aktive dhe të fuqizuar, që inkurajon pjesëmarrjen demokratike, qytetare dhe sociale të njerëzve dhe kultivon diversitetin e pasur të shoqërisë Evropiane, të bazuar në vlerat, historinë dhe kujtesën e përbashkët.

Programi CERV ka katër shtylla kryesore:

1. **Vlerat e Bashkimit** - Mbrojtja dhe promovimi i vlerave të Bashkimit Evropian;
2. **Barazia, të Drejtat dhe Barazia Gjimore** - Promovimi i të drejtave, mosdiskriminimit, barazisë (duke përfshirë barazinë gjimore) dhe përparimi i barazisë gjimore dhe mosdiskriminimit;
3. **Angazhimi dhe Pjesëmarrja e Qytetarëve** - Promovimi i angazhimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën demokratike të Bashkimit Evropian, shkëmbimet midis qytetarëve të shteteve të ndryshme anëtare dhe rritja e ndërgjegjësimit mbi historinë e përbashkët Evropiane;
4. **Daphne** - Lufta kundër dhunës, përfshirë dhunën me bazë gjimore dhe dhunën ndaj fëmijëve.

Organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në nivel lokal, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe palë të tjera të interesuara, mund të aplikojnë për të marrë financim nga programi CERV për nisma që synojnë angazhimin e qytetarëve, barazinë për të gjithë dhe mbrojtjen e të drejtave dhe vlerave të BE-së.

2. GRANTE DHE THIRRJE PËR PROJEKT-PROPOZIME

Buxheti global i rezervuar për grante në këtë program pune është parashikuar të jetë 192 500 000 EUR në vitin 2025. Thirrjet për propozime mund t'i gjeni në Portalin e Tenderave në këtë link: [CERV Programme](#)

Ndarja buxhetore sipas objektivave

Objektivi Specifik	2025 (€)
Mbrojtja dhe promovimi i vlerave të BE-së	64 675 000
Promovimi i barazisë dhe të drejtave	21 400 000
Promovimi i angazhimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën demokratike të Bashkimit	83 425 000
Daphne	23 000 000
TOTALI	192 500 000

2.1. Thirrje për propozime për të promovuar ndërgjegjësimin, ndërtimin e kapaciteteve dhe zbatimin e Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së nga organizatat e shoqërisë civile CALL: CERV-2024-CITIZENS-VALUES

Bashkitë shqiptare dhe organizatat e shoqërisë civile **nuk mund të aplikojnë** në kuadër të kësaj thirrjeje.

2.2. Thirrje për propozime për të promovuar barazinë dhe për të luftuar racizmin, ksenofobinë dhe të gjitha format e tjera të diskriminimit CALL: CERV-2024-EQUAL

Objektivat

Promovimi i barazisë, parandalimi dhe luftimi i pabarazive dhe diskriminimit mbi bazën e gjinisë, origjinës racore ose etnike, fesë ose besimit, aftësisë së kufizuar, moshës ose orientimit seksual dhe respektimi i parimit të mosdiskriminimit të përcaktuar në Nenin 21 të Kartës. Mbështetja, avancimi dhe zbatimi i politikave gjithëpërfshirëse dhe qasja ndërthurëse për të luftuar racizmin, ksenofobinë, antigypsyizmin, LGBTIQ-fobinë, antisemitizmin, racizmin anti-musliman dhe të gjitha format e diskriminimit dhe intolerancës.

Politika të mbështetura: Plani i Veprimit të BE-së kundër Racizmit (2020-2025), Strategjia për Barazinë e LGBTIQ (2020-2025), Strategjia e BE-së për luftimin e antisemitizmit, Korniza strategjike e BE-së për barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e Romëve (2020-2030), Strategjia e BE-së për të drejtat e viktimave, Strategjia për Barazi Gjinore (2020-2025).

Kush mund të aplikojë

Autoritetet publike të Shteteve Anëtare dhe vendeve pjesëmarrëse, në të gjitha nivelet, strukturat për barazinë dhe organizatat e shoqërisë civile.

Prioritetet e politikave

Projektet mund të jenë kombëtare ose ndërkombëtare, me theks të veçantë për projektet ndërkombëtare. Duke marrë parasysh objektivat e përgjithshme të përcaktuara më lart, kjo thirrje mbështet prioritetet e mëposhtme:

1. Lufta kundër diskriminimit dhe racizmit, ksenofobisë dhe formave të tjera të intolerancës, përfshirë antisemitizmin, antigypsyizmin dhe racizmin kundër personave me ngjyre, aziatik dhe musliman.
2. Promovimi i menaxhimit të diversitetit dhe përfshirjes në vendin e punës, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat.
3. Lufta kundër diskriminimit ndaj personave LGBTIQ dhe promovimi i barazisë për LGBTIQ.
4. Mbështetja për autoritetet publike në luftën kundër racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit, racizmit anti-musliman, LGBTIQ-fobisë dhe të gjitha formave të tjera të intolerancës, përfshirë diskriminimin e ndërthurur.

Aktivitete që mund të financohen

- Ndërtim koalicioni, rritje kapacitetesh dhe trajnime për profesionistët dhe viktimat e diskriminimit (ndër-sektorial);
- Mësim i ndërsjellë, shkëmbim praktikash të mira, bashkëpunim, përfshirë identifikimin e praktikave më të mira që mund të transferohen në vendet e tjera pjesëmarrëse;
- Shpërndarje dhe rritje të ndërgjegjësimit, përfshirë fushata në rrjetet sociale ose media;
- Promovim të aftësive dixhitale dhe të mendimit kritik;
- Regjistrim të të dhënave, mbledhje të të dhënave, sondazhe, monitorim dhe raportim të incidenteve të diskriminimit;
- Fuqizim dhe mbështetje për viktimat me ndjeshmëri ndaj gjinisë dhe moshës;
- Hartim dhe zbatim të strategjive ose planeve të veprimit;

- Rritje të kapaciteteve dhe aktivitete trajnimi për autoritetet kombëtare, rajonale dhe lokale.

Rezultatet e Pritshme

- 1. Lufta kundër diskriminimit dhe racizmit, ksenofobisë dhe formave të tjera të intolerancës, përfshirë antisemitizmin, antigypsyizmin dhe racizmin.**
 - Rritja e njohurive mbi legjislacionin e BE-së dhe legjislacionin kombëtar mbi mosdiskriminimin;
 - Përmirësimi i njohurive dhe zbatimit të praktikave administrative në fushën e mosdiskriminimit, përfshirë praktikat dhe politikat që mbulojnë diskriminimin e shumëfishtë;
 - Rritja e ndërgjegjësimit për të drejtat dhe vetëdijes për paragjykimet dhe stereotipet;
 - Zbatimi dhe forcimi më efektiv i legjislacionit për mosdiskriminim dhe monitorim e raportim i pavarur i përmirësuar;
 - Përmirësimi i njohurive mbi racizmin dhe format e ndryshme të tij, përfshirë racizmin strukturor dhe njohuritë mbi politikat dhe legjislacionin e BE-së;
 - Fuqizimi dhe mbrojtja më e madhe për grupet, komunitetet dhe individët e prekur nga manifestimet e intolerancës dhe racizmit, me fokus të veçantë mbi antisemitizmin, antigypsyizmin dhe racizmin kundër njerëzve me ngjyrë, aziatikëve dhe muslimanëve;
 - Përmirësimi i njohurive dhe vetëdijes dhe aftësisë për të reaguar ndaj të gjitha formave të racizmit në popullatën e përgjithshme dhe grupe kyçe si vendimmarrësit, forcat e rendit dhe drejtësia, dhe të rinjtë;
 - Rritja e njohurive mbi regjistrimin dhe mbledhjen e të dhënave mbi incidentet, me synimin e harmonizimit të metodologjive në BE.
- 2. Promovimi i menaxhimit të diversitetit dhe përfshirjes në vendin e punës, në sektorin publik dhe privat**
 - Rritja e numrit të organizatave të lidhura me Kartën e Diversitetit;
 - Rritja e njohurive dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e diversitetit dhe përfshirjes në vendin e punës;
 - Rritja e diversitetit në vendin e punës, duke u mbështetur nga lidhjet më të forta midis komunitetit akademik dhe kërkimor dhe botës së biznesit;
 - Vende pune dhe shoqëri më gjithëpërfshirëse;
 - Rritja dhe përmirësimi i udhëzimeve dhe mjeteve për të ndërtuar vende pune gjithëpërfshirëse dhe për të matur diversitetin dhe përfshirjen në vendin e punës.

3. Lufta kundër diskriminimit ndaj personave LGBTIQ dhe promovimi i barazisë për LGBTIQ

- Përmirësimi i njohurive dhe ndërgjegjësimit për diskriminimin e ndërthurur dhe pabarazitë që përjetojnë personat LGBTIQ, veçanërisht personat transgjinorë dhe interseksualë, në punësim, arsim dhe shëndetësi, si dhe zgjidhjet për adresimin e tyre;
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe përmirësimi i aftësive të profesionistëve përkatës, duke përfshirë ata të shëndetësisë, medias, biznesit dhe arsimit, për të kundërshtuar stereotipet, stigmën, patologjizimin, diskriminimin, ngacmimin dhe bullizmin që prekin personat LGBTIQ;
- Rritja e mbështetjes për personat LGBTIQ dhe familjet e tyre, përfshirë përmes fushatave të informimit, grupeve mbështetëse, këshillimit dhe mjeteve të tjera, si dhe përmirësimi i njohurive dhe ndërgjegjësimit mbi sfidat e tyre;
- Udhëzime më të mira për autoritetet kombëtare dhe ofruesit e arsimit për parandalimin dhe luftimin e dhunës në shkollë dhe bullizmit ndaj nxënësve LGBTIQ, për përfshirjen e përfaqësimeve pozitive të diversitetit LGBTIQ në arsim dhe për të adresuar stereotipet gjinore dhe të seksualitetit në edukim dhe për të përmbushur nevojat e fëmijëve transgjinorë, interseksualë dhe jo-binare;
- Përmirësimi i metodave të mbledhjes së të dhënave për të kuptuar më mirë nevojat dhe përvojat e personave LGBTIQ, duke informuar politikat dhe ndërhyrjet e bazuara në prova.

4. Mbështetje për autoritetet publike për të luftuar racizmin, ksenofobinë, antisemitizmin, racizmin anti-musliman, LGBTIQ-fobinë dhe të gjitha format e tjera të intolerancës, përfshirë diskriminimin e ndërthurur

- Përmirësimi i aftësive të autoriteteve publike për të hetuar, ndjekur dhe dënuar efektivisht incidentet e diskriminimit;
- Bashkëpunim më i fortë midis autoriteteve publike dhe organizatave të shoqërisë civile që mbledhin të dhëna mbi incidentet e diskriminimit;
- Mbështetje më e mirë për viktimat, ndërgjegjësim më i mirë i publikut për të drejtat dhe rritja e numrit të incidenteve të raportuara;
- Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet autoriteteve publike (veçanërisht administratat komunale dhe rajonale), si dhe ndërmjet autoriteteve publike dhe aktorëve të tjerë si organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e komuniteteve, për të përmirësuar përgjigjet ndaj diskriminimit, racizmit, ksenofobisë dhe formave të tjera të intolerancës;
- Njohuri dhe ndërgjegjësim më të përmirësuar ndër autoritetet publike dhe forcat e rendit mbi ndikimin e diskriminimit, racizmit, ksenofobisë dhe formave të tjera të intolerancës dhe trendet aktuale, dhe një kuptim më i mirë i formave të ndryshme të intolerancës dhe i kornizës ligjore;

- Përmirësimi i sistemit të regjistrimit të diskriminimit dhe mbledhjes së të dhënave, një qasje metodologjike më e përmirësuar dhe një bashkëpunim më i mirë ndër-institucional për mbledhjen e të dhënave;
- Zhvillimi dhe zbatimi efektiv i marrëveshjeve, strategjive ose planeve gjithëpërfshirëse për të parandaluar dhe luftuar racizmin, antisemitizmin, ksenofobinë, LGBTIQ-fobinë dhe format e tjera të intolerancës.

Përbërja e konsorciumit

Propozimet duhet të dorëzohen nga një konsorcium prej **të paktën dy aplikantësh** (përfitues; jo entitete të asociuara), i cili plotëson kushtet e mëposhtme:

- **për prioritetin e parë, të dytë dhe të tretë: përfituesit duhet të jenë entitete publike ose organizata private**, të krijuara ligjërisht në një nga vendet pjesëmarrëse në program, ose një organizatë ndërkombëtare; organizatat me qëllim fitimi duhet të paraqesin aplikimet në partneritet me entitete publike ose organizata private jofitimprurëse.
- **për prioritetin e katërt: koordinatori duhet të jetë një autoritet publik i një prej vendeve pjesëmarrëse në program**; aplikantët e tjerë duhet të jenë entitete publike ose organizata private, të krijuara ligjërisht në një nga vendet pjesëmarrëse në program, ose organizata ndërkombëtare.

2.3 Thirrje për Propozime mbi Kujtesën Evropiane CERV-2024-CITIZENS-REM — European remembrance

Objektivat

Mbështetje për projekte që synojnë përkujtimin e ngjarjeve përcaktuese në historinë moderne Evropiane, duke përfshirë shkaqet dhe pasojat e regjimeve autoritare dhe totalitare, skllavërinë dhe kolonializmin, dhe Holokaustin, si dhe rritjen e ndërgjegjësimin të qytetarët Evropianë për historinë, kulturën, trashëgiminë kulturore dhe vlerat e tyre të përbashkëta, duke përmirësuar kështu kuptimin e tyre për BE, origjinën, qëllimin, diversitetin dhe arritjet e tij, si dhe rëndësinë e mirëkuptimit dhe tolerancës së ndërsjellë. Barazia gjinore do të jetë një prioritet i ndërthurur në të gjitha projektet.

Nismat politike të mbështetura: Strategjia e BE-së për luftimin e antisemitizmit 2021-2030, Plan i Veprimt të BE-së Kundër Racizmit (2020-2025), Korniza strategjike e BE-së për barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e Romëve (2020-2030), Strategjia për Barazinë e LGBTIQ (2020-2025), Udhëzuesi për Qytetarinë e BE-së, Komunikimi i Përbashkët "Pa Vend për Urrejtjen: një Evropë e bashkuar kundër urrejtjes," Strategjia për Barazinë Gjinore (2020-2025).

Kush mund të aplikojë

Autoritetet dhe institucionet publike, organizatat e shoqërisë civile, subjektet përkujtimore dhe të trashëgimisë, muzetë dhe qendrat arkivore, shoqatat e të mbijetuarve, si dhe organizatat kulturore, rinore dhe kërkimore, ofruesit e arsimit dhe trajnimeve.

Prioritetet e politikave

Projektet mund të jenë kombëtare ose transnacionale. Projektet transnacionale inkurajohen në mënyrë të veçantë. Duke pasur parasysh objektivat e përgjithshme të përcaktuara më lart, thirrja do të mbështesë prioritetet e mëposhtme:

1. Tranzicioni demokratik, (ri)ndërtimi dhe forcimi i shoqërisë të bazuar në sundimin e ligjit, demokracinë dhe të drejtat themelore.
2. Forcimi i kujtesës për Holokaustin, gjenocidin, krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit për të fuqizuar demokracinë në BE.
3. Migracioni, dekolonizimi, skllavëria dhe shoqëritë multikulturore evropiane.

Aktivitete që mund të financohen

Projektet priten të:

- Krijojnë bashkëpunime midis organizatave të ndryshme për të krijuar sinergji (midis organizatave jofitimprurëse, administratave lokale, rajonale dhe kombëtare, akademisë dhe vendeve përkujtimore dhe të mësimit me institucionet arsimore);
- Zhvillojnë lloje të ndryshme aktivitete (aktivitete trajnimi, publikime, mjete online, kërkime, edukim joformal, debate publike, ekspozita, rritje të ndërgjegjësimit, mbledhje dhe digjitalizim të dëshmimeve, veprime inovative dhe krijuese, etj.), duke përdorur gjithashtu metoda të reja të mësimdhënies dhe teknologji të reja;
- Vendosin dhe zhvillojnë trajnime për mbrojtësit e të drejtave, nëpunësit civilë, anëtarët e gjyqësorit, zyrtarët e zbatimit të ligjit dhe politikëbërësit;
- Sigurojnë mundësi për shkëmbime ndërbrezash midis dëshmitarëve dhe gjeneratave të ardhshme;
- Përfshijnë njerëz nga grupe të ndryshme targeti dhe gjinore, duke përfshirë, aty ku është e mundur, persona që përballen me racizëm, antisemitizëm, antigjipsizëm ose forma të tjera diskriminimi dhe intolerancë.
- Projektet duhet të kenë një dimension evropian dhe preferohet të zbatohen në nivel transnacional (duke përfshirë krijimin dhe funksionimin e partneriteteve dhe rrjeteve transnacionale).

Rezultatet e pritshme

- Angazhimi i Evropianëve nga prejardhje të ndryshme – përfshirë të rinjtë dhe personat që janë multiplikues (administratorë shtetërorë, zyrtarë të rendit, anëtarë të gjyqësorit, vendimmarrës, mbrojtës të të drejtave, etj.) në avokimin, forcimin dhe mbështetjen e institucioneve dhe strukturave demokratike të bazuara në sundimin e ligjit;
- Digjitalizimi i materialit historik dhe dëshmime të dëshmitarëve okularë për qëllime edukimi dhe trajnimi;
- Përfshirja e një dimensionit Evropian në debatet kombëtare dhe ndërkombëtare mbi ngjarjet historike të rëndësishme dhe momentet e historisë së fundit Evropiane;
- Identifikimi, ruajtja dhe ofrimi, veçanërisht online, i materialeve arkivore, dëshmime dhe vendeve autentike për qëllime edukimi, përkujtimi dhe kërkimi;
- Angazhimi i Evropianëve në luftën kundër racizmit, antisemitizmit, antigypsyizmit, urrejtjes ndaj myslimanëve, fobisë ndaj LGBTIQ dhe të gjitha formave të intolerancës;
- Rritja e numrit të koalicioneve ndërkombëtare mbi kujtesën Evropiane;
- Forcimi i luftës kundër shtrembërimit, revizionizmit dhe mohimit të historisë, përfshirë mohimin, shtrembërimin dhe trivializimin e Holokaustit;
- Rritja e ndërgjegjësimit mbi kontributin e minoriteteve, si hebrenjtë, myslimanët dhe romët, në pasurinë kulturore, diversitetin dhe historinë e përbashkët të Evropës;
- Përmirësimi i njohurive rreth historisë dhe pasojave të kolonializmit, skllavërisë dhe tregtisë së skllavëve, si dhe rrënjët historike të racizmit; njohja e historive të personave me origjinë afrikane (PAD) në Evropë.

Përbërja e konsorciumit

Propozimet duhet të dorëzohen nga një konsorcium prej të paktën 2 aplikantësh (aplikanti kryesor ("Koordinatori") dhe të paktën një bashkë-aplikant, i cili nuk është entitet i lidhur (affiliated partner) ose partner i asociuar).

2.4. Thirrje për Propozime për të Nxitur Angazhimin dhe Pjesëmarrjen e Qytetarëve

CALL: CERV-2024-CITIZENS-CIV

Objektivat

Promovimi i pjesëmarrjes dhe kontributit të qytetarëve dhe shoqatave përfaqësuese në jetën demokratike dhe qytetare të Bashkimit Evropian, duke bërë të njohura dhe shkëmbyer publikisht pikëpamjet e tyre në të gjitha fushat e veprimit të BE-së.

Nismat politike të mbështetura janë: Plani i veprimit për demokracinë evropiane, Raporti mbi Qytetarinë e BE-së 2020, Paketa e Qytetarisë së BE-së, Strategjia për të forcuar zbatimin e Kartës së të Drejtave Themelore në BE, Rekomandimi i Komisionit për mbrojtjen e gazetarëve dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut që angazhohen në pjesëmarrjen publike nga procese

gjyqësore të pabaza ose abuzive ("Padi strategjike kundër pjesëmarrjes publike"), Komunikimi i 25 nëntorit 2021 mbi mbrojtjen e integritetit të zgjedhjeve dhe promovimin e pjesëmarrjes demokratike, dhe Paketa për Mbrojtjen e Demokracisë.

Kush mund të aplikojë

Organizata private jofitimprurëse, përfshirë organizatat e shoqërisë civile, organizatat kulturore dhe rinore, ofruesit e arsimit ose institucionet kërkimore.

Prioritetet e politikave

Duke pasur parasysh objektivin e përgjithshëm të përcaktuar më lart, thirrja do të mbështesë prioritetet e mëposhtme:

1. Promovimi i shkëmbimeve mbi prioritetet dhe sfidat e ardhshme të politikave të Bashkimit
2. Lufta kundër dezinformimit, manipulimit të informacionit dhe ndërhyrjes në debatin demokratik
3. Promovimi i pjesëmarrjes aktive demokratike të qytetarëve

Aktivitete që mund të financohen

Projektet duhet të mbledhin njerëz nga vende të ndryshme në aktivitete që lidhen drejtpërdrejt me politikat e BE-së. Projektet duhet të ofrojnë mundësi për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në procesin e hartimit të politikave, duke krijuar kështu kushtet për një qasje më të fuqishme nga poshtë-lart dhe një proces më përfshirës të politikëbërjes, duke promovuar angazhimin qytetar dhe demokratik.

Projektet pritet të:

- kenë partneritete të diversifikuara, ku sektori i shoqërisë civile luan një rol të rëndësishëm;
- përfshijnë lloje të ndryshme organizatash (p.sh. organizata jofitimprurëse, përfshirë organizata të shoqërisë civile, institucione arsimore, kulturore ose kërkimore, autoritete lokale/rajonale publike ose universitete); dhe
- përfshijnë ngjarje si debate, konferenca, seminare, fushata, punëtori dhe aktivitete kulturore.

Kjo thirrje për propozime mbështet aktivitete që ndihmojnë në nxitjen e demokracisë, përfshirjes dhe pjesëmarrjes demokratike në BE. Aktivitetet përfshijnë, për shembull: (i) promovimin e angazhimit shoqëror përmes debateve, fushatave, rritjes së ndërgjegjësimit, konferencave, punëtorive etj., mbi temat e rëndësishme për prioritetet e thirrjes dhe që

lidhen me agjendën politike dhe procesin e politikëbërjes në Evropë; (ii) mbledhjen e opinioneve të individëve përmes një qasjeje nga poshtë-lart (duke përfshirë përdorimin e rrjeteve sociale, ëëbinareve etj.) dhe edukimin për mediat; (iii) promovimin e shkëmbimeve ndërmjet qytetarëve të BE-së mbi temat që lidhen me BE-në për të nxitur një kuptim më të mirë të perspektivave të ndryshme; dhe (iv) identifikimin e zgjidhjeve dhe rekomandimeve të mundshme për t'u paraqitur te autoritetet politike dhe vendimmarrësit lokalë përkatës.

Rezultatet e pritshme

- Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për të drejtat dhe vlerat e BE-së dhe rritja e angazhimit të tyre në shoqëri dhe me BE-në;
- Përmirësimi i njohurive dhe kuptimit të qytetarëve për institucionet dhe politikat e BE-së, si dhe për arritjet dhe përfitimet e BE-së;
- Rritja e fuqizimit të qytetarëve për t'u përfshirë në vendimmarrje nga niveli lokal deri në atë të BE-së;
- Rritja e fuqizimit të qytetarëve për të shprehur zërin e tyre te autoritetet dhe vendimmarrësit politikë përkatës, duke ndihmuar që ata të ndikojnë në praktikë;
- Rritja e pjesëmarrjes aktive të njerëzve nga prejardhje të ndryshme në procesin e politikëbërjes në BE duke rritur kontributit në jetën demokratike dhe qytetare të Bashkimit;
- Shtimi i mundësive për qytetarët për të shprehur dhe bërë të njohura pikëpamjet e tyre për Evropën që ata dëshirojnë dhe për të përcaktuar vizionin e tyre afatgjatë për të ardhmen e integritit Evropian;
- Forcimi i pjesëmarrjes demokratike, me fokus të veçantë në përfshirjen e të rinjve dhe të moshuarve, grave në të gjithë diversitetin e tyre, qytetarëve të BE-së në lëvizje dhe personave me aftësi të kufizuara, si dhe në arritjen e atyre qytetarëve që nuk janë aktivë në pjesëmarrjen qytetare në jetën e tyre të përditshme.

Përbërja e konsorciumit

Propozimet duhet të dorëzohen nga një konsorcium prej minimumi 2 aplikantësh (aplikanti kryesor dhe të paktën një bashkë-aplikant, i cili nuk është entitet i lidhur ose partner i asociuar) nga 2 vende të ndryshme të programit.

2.5. Thirrje për të Drejtat e Fëmijës dhe Pjesëmarrjen e Fëmijëve

CALL: CERV-2024-CHILD

Objektivat

Mbështetja, avancimi dhe zbatimi i politikave gjithëpërfshirëse për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e fëmijës, përfshirë të drejtën për të marrë pjesë.

Nismat politike të mbështetura: Strategjia e BE-së për të Drejtat e Fëmijës.

Kush mund të aplikojë

Organizatat e shoqërisë civile, përfshirë ato ndërkombëtare dhe akademinë, puna e të cilave është e rëndësishme në fushën e të drejtave të fëmijës, aktorët në fushën e arsimit, autoritetet kombëtare dhe lokale.

Prioritetet e politikave

Projektet mund të jenë kombëtare ose ndërkombëtare. Projektet ndërkombëtare inkurajohen në mënyrë të veçantë. Duke pasur parasysh objektivin e përgjithshëm të përcaktuar më lart, thirrja do të mbështesë prioritetet e mëposhtme:

1. Të drejtat e fëmijëve në epokën dixhitale.
2. Integrimi i perspektivës së të drejtave të fëmijës në veprimet në nivel kombëtar dhe lokal.
3. Angazhimi dhe pjesëmarrja e fëmijëve.

Aktivitete që mund të financohen mund të përfshijnë:

- Mësim të ndërsjellë, trajnime, shkëmbim të praktikave të mira, bashkëpunim dhe rrjetëzim;
- Shpërndarje dhe rritje të ndërgjegjësimit, përfshirë fushata në rrjetet sociale ose media;
- Rritje të kapaciteteve dhe aktivitete trajnimi për autoritetet kombëtare, rajonale dhe lokale;
- Aktivitete trajnimi dhe sesione ndërgjegjësimi për fëmijët;
- Hartim dhe zbatim të protokolleve, zhvillim të metodave dhe mjeteve të punës.

Rezultatet e Pritshme

- Rritja e ndërgjegjësimit të fëmijëve për të drejtat e tyre në botën online, si dhe për mundësitë dhe rreziqet që ajo përmban;
- Rritja e ndërgjegjësimit të fëmijëve për të drejtën e tyre për të marrë pjesë dhe për të bërë të dëgjohet zëri i tyre;
- Rritja e efektivitetit të mekanizmave të pjesëmarrjes së fëmijëve, duke i bërë ato gjithëpërfshirëse dhe sistematike;
- Përmirësimi i ndërtimit të kapaciteteve, shkëmbimi i praktikave të mira dhe trajnimi mbi të drejtat dhe nevojat e fëmijëve;
- Përmirësimi i mbështetjes për fëmijët në situata vulnerable ose për ata që janë me më pak mundësi.

Përbërja e Konsorciumit

Propozimet duhet të dorëzohen nga një konsorcium prej të paktën 2 aplikantësh (përfitues; jo entitete të lidhura ose partnerë të asociuar).

2.6. Thirrje për Propozime për Binjakëzimin e Qyteteve

Call: CERV-2024-CITIZENS-TOËN-TT — Town-Twinning

Objektivat

Promovimi i shkëmbimeve midis qytetarëve nga vende të ndryshme, veçanërisht përmes binjakëzimit të qyteteve, për t'u dhënë atyre një përvojë praktike të pasurisë dhe diversitetit të trashëgimisë së përbashkët të Bashkimit dhe për t'i bërë të vetëdijshëm se këto përbëjnë themelin për një të ardhme të përbashkët.

Nismat politike të mbështetura: Plani i veprimit për demokracinë Evropiane, Plani i Veprimit të BE-së Kundër Racizmit (2020-2025), Korniza strategjike e BE-së për barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e Romëve (2020-2030), Promovimi i diversitetit dhe përfshirjes (Kartat e Diversitetit), Strategjia për forcimin e zbatimit të Kartës së të Drejtave Themelore në BE, Raporti mbi Qytetarinë e BE-së 2020, Strategjia për Barazinë Gjinore, Strategjia për Barazinë LGBTIQ (2020-2025), Strategjia për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2021-2030), Strategjia e BE-së për të Drejtat e Fëmijës, paketa për Qytetarinë e BE-së, Rekomandimi për zgjedhje gjithëpërfshirëse dhe rezistente, si pjesë e paketës "Mbrojtja e Demokracisë".

Kush mund të aplikojë

Qytete/bashki ose komitetet apo rrjetet e tyre të binjakëzimit; nivele të tjera të autoriteteve lokale/rajonale; federata/shoqata të autoriteteve lokale; organizata jofitimprurëse që përfaqësojnë autoritetet lokale.

Prioritetet e politikave

Duke pasur parasysh objektivin e përgjithshëm të përcaktuar më lart, thirrja mund të trajtojë temat e mëposhtme (lista nuk është përfundimtare):

- BE-ja është ndërtuar mbi solidaritetin: solidaritetin midis qytetarëve të saj, solidaritetin përtej kufijve midis shteteve anëtare dhe solidaritetin përmes veprimeve mbështetëse brenda dhe jashtë BE-së.
- Projektet e Binjakëzimit të Qyteteve do t'u japin qytetarëve mundësinë të shprehin çfarë Evrope dëshirojnë të ndërtojnë dhe jetojnë.
- Projektet mund të mbulojnë promovimin e një pjesëmarrjeje të gjerë dhe gjithëpërfshirëse në proceset demokratike dhe në vendimmarrje, përfshirë fëmijët.

- Projektet mund të mbulojnë promovimin e ndërgjegjësimit dhe ndërtimin e njohurive për të drejtat e qytetarisë së BE-së, lëvizjen e lirë të njerëzve dhe vlerat e përbashkëta Evropiane dhe standardet demokratike të përbashkëta, duke i bërë ato më të prekshme për qytetarët e BE-së.
- Projektet gjithashtu mund të përfshijnë aktivitete parandalimi dhe rritje të ndërgjegjësimit nga qytetet dhe autoritetet lokale në fushën e dhunës në familje, si dhe çdo formë të dhunës ndaj fëmijëve, përfshirë (kibernetikën) bullizmin dhe ngacmimin.
- Projektet gjithashtu mund të eksplorojnë metoda për përmirësimin e pjesëmarrjes demokratike të qytetarëve përmes aktiviteteve kulturore, duke përfshirë frymëzimin nga ose lidhjen me iniciativën e Bauhaus-it të Ri Evropian.

Aktivitete që mund të financohen

Aktivitetet e Binjakëzimit të Qyteteve duhet të përfshijnë minimumi 50 pjesëmarrës të drejtpërdrejtë, nga të cilët minimumi 25 pjesëmarrës janë "pjesëmarrës të ftuar". "Pjesëmarrësit e ftuar" janë delegacione udhëtuese nga vende partnere të projektit, përveç vendit mikpritës të aktivitetit të Binjakëzimit të Qyteteve.

Aktivitetet e lidhura me Binjakëzimin e Qyteteve mund të përfshijnë, ndër të tjera:

- Workshope,
- Seminare,
- Konferenca,
- Aktivitete trajnimi,
- Takime ekspertësh,
- Webinare,
- Aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit,
- Ngjarje kulturore, festivale, ekspozita,
- Mbledhja dhe konsultimi i të dhënave (të ndara sipas gjinisë),
- Zhvillimi, shkëmbimi dhe shpërndarja e praktikave të mira ndërmjet autoriteteve publike dhe organizatave të shoqërisë civile,
- Zhvillimi i mjeteve të komunikimit dhe përdorimi i rrjeteve sociale.

Rezultatet e pritshme

- Rritja dhe inkurajimi i mirëkuptimit dhe miqësisë së ndërsjellë midis qytetarëve në nivel lokal;
- Mbështetje për qytetarët nga komunitetet lokale për të përjetuar dhe njohur vlerën e shtuar që BE-ja ofron përmes një qasjeje të bazuar te komuniteti;
- Rritja e ndjenjës së përkatësisë ndaj BE-së;
- Inkurajimi i një lidhjeje të qëndrueshme midis bashkive dhe midis qytetarëve;
- Rritja e bashkëpunimit ndërkufitar rreth çështjeve praktike të pjesëmarrjes demokratike midis bashkive dhe qytetarëve, duke shkuar përtej shkëmbimit kulturor;

- Rritja e ndërgjegjësimit mbi politikat efektive për parandalimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj fëmijëve në nivel lokal;
- Përfshirja aktive e grupeve të disavantazuara dhe komuniteteve të marginalizuara;
- Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në aktivitete kulturore gjithëpërfshirëse dhe kuptimplote dhe shtimi i kontakteve të qytetarëve me trashëgiminë e pasur kulturore të Evropës.

Përbërja e Konsorciumit

Lejohen vetëm aplikimet nga aplikantë të vetëm (përfitues të vetëm).

Propozimet për Binjakëzimin e Qyteteve duhet të përfshijnë bashki nga të paktën 2 vende të pranueshme, nga të cilat të paktën njëri duhet të jetë Shtet Anëtar i BE-së.

2.7. Thirrje për Propozime për Rrjetet e Qyteteve

CALL: CERV-2024-CITIZENS-TOWN-NT

Objektivat

Promovimi i shkëmbimeve midis qytetarëve nga vende të ndryshme, veçanërisht përmes rrjeteve të qyteteve, për t'u dhënë atyre një përvojë praktike të pasurisë dhe diversitetit të trashëgimisë së përbashkët të Bashkimit Evropian dhe për t'i bërë të vetëdijshëm se këto përbëjnë themelin për një të ardhme të përbashkët.

Zhvillimi i rrjeteve të qëndrueshme të qyteteve, thellimi dhe intensifikimi i bashkëpunimit të tyre, duke përcaktuar një vizion afatgjatë për të ardhmen e integritetit Evropian.

Nismat politike të mbështetura: Plani i veprimit për demokracinë Evropiane, Korniza strategjike e BE-së për barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e Romëve (2020-2030), Plani i Veprimit të BE-së Kundër Racizmit (2020-2025), Strategjia për Barazinë LGBTIQ (2020-2025), Strategjia për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2021-2030), promovimi i diversitetit dhe përfshirjes (Kartat e Diversitetit), Raportet e Qytetarisë së BE-së dhe Paketa e Qytetarisë së BE-së, Rekomandimi i Komisionit për zgjedhje gjithëpërfshirëse dhe rezistente, Rekomandimi i Komisionit për promovimin e angazhimit dhe pjesëmarrjes efektive të qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile në proceset e politikëbërjes publike, Strategjia për Barazinë Gjinore, Strategjia e BE-së për të Drejtat e Fëmijës.

Kush mund të aplikojë

Qytete/bashki ose komitetet apo rrjetet e tyre të binjakëzimit; nivele të tjera të autoriteteve lokale/rajonale; federata/shoqata të autoriteteve lokale; organizata jofitimprurëse që përfaqësojnë autoritetet lokale.

Prioritetet e politikave

Duke pasur parasysh objektivin e përgjithshëm të përcaktuar më lart, thirrja mund të trajtojë temat e mëposhtme (lista nuk është përfundimtare):

- Bashkimi i qytetarëve për të diskutuar dhe ndarë praktikën më të mirë, duke ndihmuar kështu në rritjen e angazhimit të qytetarëve në shoqëri dhe, përfundimisht, në përfshirjen e tyre aktive në jetën demokratike të Bashkimit Evropian
- Promovimi i ndërgjegjësimit dhe ndërtimi i njohurive për të drejtat e qytetarisë së BE-së, lëvizjen e lirë të njerëzve dhe vlerat e përbashkëta evropiane, si dhe standardet demokratike të përbashkëta, duke i bërë më të prekshme për qytetarët e BE-së
- Identifikimi i mënyrave për të forcuar më tej dimensionin evropian dhe legjitimitetin demokratik të procesit të vendimmarrjes së BE-së dhe nxitja e qeverisjes demokratike të hapur dhe të shëndetshme në një epokë të pjesëmarrjes së ulët në zgjedhje, populizmit, dezinformimit dhe sfidave që përballen me shoqërinë civile, përfshirë mbështetjen për pjesëmarrjen aktive të qytetarëve, përfshirë fëmijët, dhe organizatat e shoqërisë civile në hartimin e politikave në nivel lokal, kombëtar dhe evropian
- Promovimi i ndërgjegjësimit, ndërtimi i njohurive dhe ndarja e praktikave më të mira mbi përfitimet e diversitetit si dhe masat efektive se si të luftohet diskriminimi dhe racizmi në nivel lokal
- Promovimi i ndërgjegjësimit dhe ndërtimi i njohurive për rolin e minoriteteve, si njerëzit nga minoritetet retnike apo pakicat (për shembull, romët dhe migrantët), në shoqërinë Evropiane dhe kontributin e tyre në zhvillimin kulturor të Evropës
- Promovimi i masave parandaluese dhe përpjekjet për ndërgjegjësimin, ndarja e praktikave më të mira të politikave që synojnë reduktimin e dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës ndaj fëmijëve në nivel lokal, si dhe bullizmit
- Projektet gjithashtu mund të promovojnë ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e pjesëmarrjes demokratike të qytetarëve përmes aktiviteteve kulturore, duke përfshirë frymëzimin nga ose lidhjen me iniciativën Bauhaus-i i Ri Evropian.

Aktivitete që mund të financohen

Aktivitetet mund të përfshijnë, ndër të tjera: workshope, seminare, konferenca, aktivitete trajnuese, takime ekspertësh, ëebinare, aktivitete për ngritjen e ndërgjegjësimit, ngjarje me dukshmëri të lartë, mbledhje dhe konsultim të të dhënave, zhvillim, shkëmbim dhe shpërndarje të praktikave të mira midis autoriteteve publike dhe organizatave të shoqërisë civile, zhvillim të mjeteve të komunikimit dhe përdorim të rrjeteve sociale.

Në kuadër të kësaj thirrje, ftohen bashkitë ose rajonet dhe shoqatat të bashkëpunojnë ne terma afatgjatë për të zhvilluar rrjete qytetesh, për të bërë bashkëpunimin e tyre më të qëndrueshëm dhe për të shkëmbyer praktikën më të mirë.

Rrjetet e Qyteteve pritet të integrojnë një gamë të gjere aktiviteteve mbi tema me interes të përbashkët në përputhje me objektivat e programit, të përfshijnë anëtarë aktive të komunitetit në këtë fushë dhe të synojnë ti bëjnë këto rrjete të qëndrueshme.

Rezultatet e Pritshme

- Rritja e angazhimit të qytetarëve në shoqëri dhe përfshirja e tyre aktive në jetën demokratike të BE;
- Krijimi i lidhjeve të qëndrueshme ndërmjet organizatave partnere;
- Informim më i mirë mbi të drejtat që ofron qytetaria e BE-së dhe përmirësimi i zbatimit të tyre në Shtetet Anëtare;
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe përmirësimi i informimit për qytetarët e BE-së në lëvizje dhe anëtarët e familjeve të tyre mbi të drejtat e qytetarisë së BE-së;
- Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile në proceset e politikëbërjes në nivel lokal, kombëtar dhe Evropian;
- Rritja e ndërgjegjësimit mbi përfitimet e diversitetit dhe lufta kundër diskriminimit dhe racizmit;
- Rritja dhe inkurajimi i mirëkuptimit dhe respektit të ndërsjellë për minoritetet Evropiane, siç janë romët;
- Rritja e ndërgjegjësimit mbi kontributin e migracionit, migrantëve dhe pasardhësve të tyre në pasurinë kulturore, diversitetin dhe historinë e përbashkët të Evropës;
- Rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e pjesëmarrjes së qytetarëve, përfshirë përmes aktiviteteve kulturore;
- Rritja e ndërgjegjësimit mbi politikat efektive për parandalimin e dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës ndaj fëmijëve në nivel lokal.

Përbërja e konsorciumit

Propozimet duhet të paraqiten nga një konsorcium prej të paktën 4 aplikantësh (përfutues), i cili plotëson kushtet e mëposhtme: entitetet janë qytete/bashki dhe/ose nivele të tjera të autoriteteve lokale, komitetet e tyre të binjakëzimit ose organizata të tjera jofitimprurëse që përfaqësojnë autoritetet lokale; këto entitete duhet të jenë nga të paktën 4 vende të ndryshme të pranueshme, nga të cilat të paktën 2 duhet të jenë Shtete Anëtare të BE-së.

2.8. Thirrje për Propozime për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës ndaj Fëmijëve

CALL: CERV-2024-DAPHNE

Objektivat

Për të luftuar dhunën, përfshirë dhunën me bazë gjinore dhe dhunën ndaj fëmijëve, duke:

- Parandaluar dhe luftuar në të gjitha nivelet dhe të gjitha format e dhunës me bazë gjinore kundër grave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre dhe dhunën në familje, përfshirë përmes promovimit të standardeve të përcaktuara në Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;

- Parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës ndaj fëmijëve, të rinjve dhe grupeve të tjera në rrezik, si personat LGBTIQ dhe personat me aftësi të kufizuara;
- Mbështetur dhe mbrojtur të gjithë viktimat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të formave të dhunës të përmendura në pikat (1) dhe (2), si viktimat e dhunës në familje të kryer brenda familjes ose brenda marrëdhënieve intime, përfshirë fëmijët që kanë mbetur jetimë si rezultat i krimeve në familje, dhe për të ofruar të njëjtin nivel mbrojtjeje në të gjithë BE për viktimat e dhunës me bazë gjinore.

Nismat politike të mbështetura: Strategjia për Barazinë Gjinore (2020-2025), Strategjia e BE-së për të Drejtat e Fëmijës, Strategjia e BE-së për të Drejtat e Viktimave, Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), të cilës BE-ja iu bashkua më 1 tetor 2023, Direktiva për luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, Direktiva mbi të Drejtat e Viktimave, Rekomandimi i Komisionit për zhvillimin dhe forcimin e sistemeve të integruara të mbrojtjes së fëmijëve në interesin më të mirë të fëmijës, Rekomandimi për praktikën e dëmshme (parashikuar për pranverën 2024), Strategjia për Barazinë LGBTIQ (2020-2025), Plani i Veprimit të BE-së Kundër Racizmit (2020-2025), Korniza Strategjike e BE-së për barazinë, pjesëmarrjen dhe përfshirjen e Romëve (2020-2030).

Aplikantët e Synuar

Autoritetet publike të Shteteve Anëtare, shërbimet mbështetëse, organizatat e shoqërisë civile.

Prioritetet e politikave

Projektet mund të jenë kombëtare ose transnacionale. Projektet transnacionale inkurajohen në mënyrë të veçantë. Duke pasur parasysh objektivat e përgjithshme të përcaktuara më lart, thirrja do të mbështesë prioritetet e mëposhtme:

1. Veprime transnacionale në shkallë të gjerë dhe afatgjata për trajtimin e dhunës me bazë gjinore.
2. Veprime të synuara për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave dhe të mbijetuarve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.
3. Veprime të synuara për parandalimin e dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën kibernetike.
4. Veprime të synuara për zbatimin në praktikë të sistemeve të integruara të mbrojtjes së fëmijëve.

Aktivitetet që mund të financohen

- Zhvillimin e mjeteve për të ndihmuar në njohjen dhe adresimin e shenjave të hershme të dhunës në familje dhe dhunës ndaj fëmijëve;
- Rritjen e ndërgjegjësimit, duke përfshirë fushata në rrjetet sociale ose në media, aktivitetet e komunikimit dhe shpërndarjen e informacionit, përfshirë aktivitete

analitike si mbledhja e të dhënave dhe kërkime, krijimin dhe zbatimin e mjeteve ose strategjive dhe sistemeve për mbledhjen e të dhënave;

- Rritjen e kapaciteteve dhe trajnime për profesionistët dhe palët e interesuara, në veçanti programe trajnimi për trajnerët, aktivitete trajnimi për autoritetet kombëtare, rajonale dhe lokale;
- Hartimin dhe zbatimin e strategjive, protokolleve, zhvillimin e metodave dhe mjeteve të punës të transferueshme, platforma dhe grupe koordinuese;
- Hartimin e shërbimeve dhe masave për përmirësimin e aksesit në shërbimet e mbështetjes për viktimat;
- Identifikimin dhe shkëmbimin e praktikave të mira, bashkëpunimin, mësimin e ndërsjellë, zhvillimin e metodave të punës dhe të mësimit, përfshirë programet mentorimi të transferueshme;
- Zhvillimin e udhëzimeve dhe manualeve për shërbimet mbështetëse të specializuara (p.sh. në vendin e punës, shkolla, universitete, online).

Rezultatet e pritshme

1. Veprime ndërkombëtare në shkallë të gjerë dhe afatgjata për trajtimin e dhunës me bazë gjinore

- Zbatimi i ndryshimeve sistemike përmes, p.sh., reformave strukturore, angazhimeve të qarta dhe ndryshimeve të proceseve, protokolleve, politikave dhe praktikave të organizatave/kompanive/strukturave, etj.;
- Rritja e kapacitetit të palëve të interesuara dhe profesionistëve përkatës (përfshirë organizatat lokale dhe profesionistët e shëndetësisë) për të adresuar çështjet e dhunës me bazë gjinore, përfshirë përmes bashkëpunimit të fortifikuar ndërmjet agjencive;
- Rezultate të pritshme të përmendura për prioritetet e tjera më poshtë (korresponduese me format e dhunës me bazë gjinore që adresohen).

2. Veprime të synuara për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave dhe të mbijetuarve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje

- Rritja e disponueshmërisë, aksesit dhe cilësisë së shërbimeve të mbështetjes së viktimave, përfshirë ato që ofrojnë mbështetje të synuar dhe të integruar për viktimat me nevoja specifike, si viktimat e dhunës seksuale dhe dhunës në marrëdhënie të afërta, duke ofruar mbështetje për traumën dhe këshillim;
- Viktimat në situata veçanërisht të cënueshme dhe grupet me rrezik të lartë që kanë qasje më të mirë në shërbimet e mbrojtjes dhe mbështetjes që adresojnë nevojat e tyre specifike;
- Rritja e kapacitetit të palëve të interesuara dhe profesionistëve në vijën e parë;
- Rritja e raportimeve të dhunës tek policia dhe shërbimet e tjera, me mekanizma të përshtatshëm në vend për të lehtësuar këtë, duke siguruar që viktimat të trajtohen në mënyrë të ndjeshme ndaj gjinisë;
- Rritja e ndërgjegjësimit për dhunën me bazë gjinore, përfshirë dhunën seksuale me bazë gjinore, përfshirë në kontekstin e migrimit dhe/ose në kontekstin e konflikteve të armatosura;
- Struktura për parandalimin dhe përgjigjet ndaj dhunës kundër grave, fëmijëve dhe grupeve të tjera të veçanta janë zgjeruar ose përshtatur për të përfshirë refugjatët dhe migrantët e tjerë; përmirësimi i standardeve të mbrojtjes dhe

mbështetjes për viktimat e dhunës me bazë gjinore, përfshirë njerëzit në migrim;

- Bashkëpunimi i fortifikuar ndërmjet agjencive lidhur me dhunën me bazë gjinore, përfshirë situatat ndërkufitare;
- Mbrojtje më e fortë e viktimave, përfshirë në rastet ndërkufitare të dhunës, përmes zbatimit të Direktivës 2011/99/BE mbi urdhrin e mbrojtjes Evropiane.

3. Veprime të synuara për parandalimin e dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën kibernetike

- Rritja e promovimit dhe mbështetjes së parandalimit të dhunës me bazë gjinore përmes ndërgjegjësimit, shpërndarjes së informacionit dhe njohurive, si dhe krijimit dhe shpërndarjes së mundësive të trajnimit;
- Rritja e ndërgjegjësimit mbi paragjykimet, stereotipet gjinore dhe normat që kontribuojnë në tolerimin e dhunës me bazë gjinore;
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe përfshirja e burrave dhe djemve në trajtimin e dhunës me bazë gjinore kundër grave;
- Rritja e kapacitetit të palëve të interesuara dhe profesionistëve përkatës për të adresuar çështjet e dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën kibernetike dhe dhunën në familje;
- Fuqizimi i rritur i (potencialëve) viktimat të dhunës për të kërkuar të drejtat e tyre dhe për t'u përballur me dhunën;
- Ndryshimi i qëndrimeve dhe sjelljeve lidhur me çështjen e dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën kibernetike (përfshirë tolerancën më të ulët dhe zvogëlimin e fajësimit të viktimave): midis popullsisë së përgjithshme dhe grupeve të veçanta, p.sh., profesionistë përkatës, dëshmitarë dhe kalimtarë, persona në situata të cenueshme dhe grupe me rrezik të lartë, etj. DHE midis burrave dhe djemve.
- Shenjat e hershme të dhunës janë të detektuara dhe raportuara; rritja e raportimeve të dhunës tek policia dhe shërbimet e tjera, me mekanizma të përshtatshëm për të lehtësuar këtë;
- Rritja e trajtimit të autorëve të dhunës;
- Parandalimi i dhunës, përfshirë dhunën online, para se të ndodhë; zvogëlimi i rrezikut të përshkallëzimit të dhunës; rritja e sigurisë së grave dhe fëmijëve të tyre dhe të tjerëve të rrezikuar nga dhuna në marrëdhënie të afërta dhe dhunë online.

4. Veprime të synuara për zbatimin në praktikë të sistemeve të integruara të mbrojtjes së fëmijëve

- Forcimi i sistemeve të integruara të mbrojtjes së fëmijëve;
- Forcimi i parandalimit, mbrojtjes dhe mbështetjes për fëmijët që vuajnë nga dhuna dhe kanë nevojë për mbrojtje;
- Rritja e kapacitetit të profesionistëve për të parandaluar, detektuar dhe reaguar ndaj dhunës kundër fëmijëve dhe mbrojtjes së fëmijëve, duke përfshirë rritjen e bashkëpunimit ndërmjet shërbimeve përkatëse.

Përbërja e konsorciumit

Propozimet duhet të dorëzohen nga një konsorcium prej të paktën 2 aplikantësh

3. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR TË BËRË NJË APLIKIM

Propozimet duhet të dorëzohen përpara afatit të thirrjes (shikoni afatin e seciles thirrje). Propozimet duhet të dorëzohen elektronikisht përmes Sistemit Elektronik të Dorëzimit në **Portalin e Financimeve & Tenderave**.

Propozimet (përfshirë anekset dhe dokumentet mbështetëse) **duhet të dorëzohen duke përdorur formatet e ofruara brenda Sistemit të Dorëzimit** (JO dokumentet e disponueshme në faqen e thirrjes — ato janë vetëm për informacion).

Propozimet duhet të jenë të plota dhe të përmbajnë të gjitha informacionet e kërkuara dhe të gjitha anekset dhe dokumentet mbështetëse të nevojshme:

- **Formulari i Aplikimit Pjesa A** - përmban informacion administrativ mbi pjesëmarrësit (koordinatorin e ardhshëm, përfituesit dhe entitetet e lidhura) dhe buxhetin e përmbledhur për projektin (duhet të plotësohet direkt online).
- **Formulari i Aplikimit Pjesa B** - përmban përshkrimin teknik të projektit (duhet të shkarkohet nga Sistemi në Portal, të plotësohet dhe më pas të bashkohet dhe të ringarkohet)
- **Pjesa C** - (duhet të plotësohet direkt online) përmban të dhëna shtesë të projektit, përfshirë indikatorët e detyrueshëm.
- **Anekset e detyrueshme:** Formulari i buxhetit me shumë të përcaktuar (model i disponueshëm në Sistemin Online).

Dokumente mbështetëse të cilat janë të ndryshme në varesi të thirrjes (duhet të ngarkohen):

- **lista e projekteve të mëparshme** (projektet kryesore për 4 vitet e fundit, (model i disponueshëm në Pjesën B).
- **CV të stafit të projektit (nëse kërkohet në thirrje)**
- **Raport vjetor i organizatës (nëse kërkohet në thirrje)**
- për pjesëmarrësit që zbatojnë aktivitete që përfshijnë fëmijë (të rinj nën moshën 18 vjeç): **një deklaratë për respektimin e kërkesave të mbrojtjes së fëmijëve** duhet të nënshkruhet në fazën e përgatitjes së grantit (GAP) nëse aplikimi përzgjidhet.

Gjatë dorëzimit të propozimit, duhet të konfirmoni që keni mandatin për të vepruar për të gjithë aplikantët. Gjithashtu, duhet të konfirmoni që informacioni në aplikim është i saktë dhe i plotë dhe që pjesëmarrësit plotësojnë kushtet për të marrë fonde të BE-së (veçanërisht kapacitetin e përshtatshëm për financim, kapacitetin financiar dhe operacional, përjashtime, etj). **Para nënshkrimit të grantit, çdo përfitues dhe entitet i lidhur do të duhet ta konfirmojë këtë përsëri duke nënshkruar një deklaratë nderi (DoH).** Propozimet pa mbështetje të plotë do të refuzohen.

4. REGJISTRIMI I BASHKISË NË PORTALIN “FINANCIMET DHE TENDERAT”

4.1 - Si të kontrolloni nëse Bashkia/Organizata juaj ka një numër PIC?

Shkoni në këtë link [how-to-participate/participant-register](https://webgate.ec.europa.eu/cas/eim/external/register.cgi), në të majtë të ekranit tuaj klikoni butonin FUNDING dhe zgjidhni opsionin e dytë PARTICIPANTS REGISTER ku do t’ju shfaqet dritarja si më poshtë.

The screenshot shows the 'Participant Register' page on the EU Funding & Tenders Portal. At the top, there's a navigation bar with links: Home, Funding (selected), Procurement, Projects & results, News & events, Work as an expert, and Guidance & documents. Below the navigation bar, the breadcrumb trail reads: Home > Funding > Participant Register. The main heading is 'Participant Register'. A blue box with an information icon states: 'The participant register is now multilingual! Select your preferred language from the top right corner of the Portal.' Below this, text explains that organizations need to be registered and have a 9-digit Participant Identification Code (PIC), which must be quoted in all correspondence. It also mentions that the register contains all participants of EU programmes. A section titled 'Is your organisation already registered? PIC search' provides instructions to check if the organization is already registered. At the bottom, there is a blue button with a magnifying glass icon and the text 'Find a registered organisation'.

Duke klikuar mbi FIND REGISTERED ORGANISATION do të keni mundësi që përmes filtrave në të majtë të zgjidhni opsionet për të parë nëse bashkia/ organizata juaj është e regjistruar apo jo dhe nëse PIC është i vlefshëm. Shikoni fotografinë ilustruese më poshtë e cila tregon se psh: Bashkia Tiranë është e regjistruar dhe ka një numër të vlefshëm (validated) PIC.

The screenshot shows the search results for 'Bashkia Tirane' on the EU Funding & Tenders Portal. The breadcrumb trail is: Home > Funding > Participant register > Find a registered organisation. The main heading is 'Find a registered organisation'. On the left, there are filters: 'Filters' (1 item(s) found), 'Quick search' (Bashkia Tirane), 'Match whole words only' (checked), 'Albania' (selected), 'Organisation type', 'Validation status', and 'All filters'. The search results show one item: 'BASHKIA TIRANE' with PIC 938474419, a flag for Albania, and VAT: ALK11729002L. The item is marked as 'Validated' and has a 'Contact' button. The page also shows 'Items per page: 10' and 'Showing 1-1 of 1'.

Nëse bashkia apo institucioni juaj nuk rezulton i regjistruar në këtë portal. Atëherë ndiqni hapat më poshtë për të regjistruar dhe marrë numrin PIC.

4.2 Si të merrni numrin PIC (Participant Identification Code)

Hapi 1: Krijoni llogarinë tuaj të përdoruesit (EU Log IN) duke klikuar mbi këtë link <https://webgate.ec.europa.eu/cas/eim/external/register.cgi> dhe duke plotësuar të dhënat përkatëse për personin që do të menaxhojë këtë llogari për bashkinë/organizatën tuaj.

Create an account

[Help for external users](#)

First name

Last name

E-mail

Confirm e-mail

E-mail language

☐ By checking this box, you acknowledge that you have read and understood the [privacy statement](#)

Nëse Bashkia/ Organizata juaj e ka tashmë një numër PIC, atëherë kaloni direkt tek Hapi 2 dhe logohuni me kredencialet tuaja.

Këtu mund të gjëni dhe udhëzimin në Anglisht:

<https://webgate.ec.europa.eu/funding-tenders-opportunities/display/OM/EU+Login>

Hapi 2:

4.3 Regjistroni bashkinë/organizatën tuaj
 Shkoni në këtë link [how-to-participate/participant-register](#), në të majtë

të ekranit tuaj klikoni butonin FUNDING dhe zgjidhni opsionin e dytë PARTICIPANTS REGISTER ku do t'ju shfaqet dritarja si më poshtë.

Klikoni mbi butonin blu REGISTER YOUR ORGANISATION dhe plotësoni të dhënat e kërkuara nga sistemi.



EU Funding & Tenders Portal

[Home](#)
[Funding](#)
[Procurement](#)
[Projects & results](#)
[News & events](#)
[Work as an expert](#)
[Guidance & documents](#)

[Sign in](#) [EN](#)

Register your organisation

To register your organisation or as a natural person, you need to login into the Portal or, if you are a new user, create your account.

Check what information you need to register in the Online Manual - and keep it to hand during the registration procedure. To start registration, click on the button below.

[Register your organisation](#)

You can suspend the registration process at any time: the data entered can be saved as draft and you can continue your registration later. To return to your registration, please log in and get into My Organisation(s) in the My Area section. Incomplete, draft registrations are automatically deleted after one year.

Additionally, for actions where the SME status is an eligibility criterion (like, e.g. the EIC Accelerator) you must also carry out the SME self-assessment.

Should your project or tender be successfully evaluated, the registered data will be verified by the Central Validation Service team before the signature of the Grant Agreement or of the Framework Contract.

Funding & Tenders Portal requires you to authenticate

Sign in to continue

Welcome back

@yahoo.com
(External)

[Sign in with a different e-mail address?](#)

Password

[Lost your password?](#)

Choose your verification method

☒ Password
 Authenticate to EU Login with only your password.

KUJDES: për të kaluar në këtë hap ju duhet të bëni **LOG IN** me kredencialet e llogarisë së regjistruar në HAPIN 1, në mënyrë që të keni akses për të regjistruar Bashkinë/Organizatën tuaj.

Hapi 3: Përgatitni të gjithë informacionin e nevojshëm

Për të regjistruar bashkinë/organizatën tuaj, do t'ju duhet të jepni të dhëna bazë administrative dhe ligjore, si dhe disa detaje kontakti.

- **Emri ligjor:** emri ligjor i organizatës që duhet të korrespondojë me emrin ligjor zyrtar në statutin e organizatës.
- **Vendi i themelimit/regjistrimit:** Zgjidhni 'Vendin e themelimit/Regjistrimit' të Bashkisë/organizatës nga lista.
- **Numri i NIPT-it:** Jepni 'numrin e NIPT-it të bashkisë/organizatës (nëse disponohet). Zgjidhni opsionin "not applicable" nëse nuk keni një numër NIPT-i.
- **Numri i Regjistrimit:** Futni "numrin e regjistrimit" të bashkisë/organizatës (nëse disponohet). Ky është një kod unik që identifikon bashkinë/organizatën tuaj, i siguar zakonisht nga Vendimi i Regjistrimit/ Vendimi i Gjykatës.
- **Faqja e internetit:** Specifikoni faqen e internetit (nëse keni) për komunikim zyrtar me Bashkinë/organizatën.

Si parim i përgjithshëm, një bashki/organizatë duhet të ketë personalitet juridik për t'u regjistruar.

Meqenëse informacioni i deklaruar mund të duhet të verifikohet më vonë me dokumentet mbështetëse, është e dobishme të keni në dorë informacionin përkatës kur përfundoni regjistrimin për t'u siguruar që të plotësoni saktë fushat përkatëse (jofitimprurëse, publike/private, etj.).

Hapi 4: Filloni aplikimin tuaj në Regjistrin e Pjesëmarrësve

Në këtë hap, ju duhet të jepni informacionin bazë ligjor të bashkisë/organizatës suaj.

Kur futni emrin ligjor të bashkisë/organizatës tuaj dhe shtetin e regjistrimit, mund të shihni një listë të bashkive dhe organizatave të tjera me informacion të ngjashëm. Kjo do të thotë se mund të ketë dublikatë në sistem. **Nëse gjeni një llogari me të dhënë që përputhen me tuajën, mos vazhdoni me procesin e regjistrimit.** Në vend të kësaj, përdorni butonin "Përdorni këtë PIC" për të kontaktuar me LEAR (Përfaqësuesin e emëruar të një personi juridik) të asaj organizate. Nëse nuk gjeni një bashki/organizatë që përputhet, klikoni në "Vazhdo regjistrimin" për të vazhduar në hapin tjetër.

4.4 Çfarë të bëni nëse keni dy numra PIC? Klikoni në linkun më poshtë dhe ndiqni me kujdes udhëzimet e dhëna në platformë: [Link](#)

5. KU TË GJEJMË PARTNERË DHE MODELI I THIRRJES PËR PARTNERË

Në platformat e mëposhme mund të gjeni partnerë për projektet tuaja:


Platforma e Financimeve dhe Tenderave – ofron një mekanizëm për të publikuar thirrjet tuaja për partnerë dhe për të gjetur partnerë të mundshëm për projektet tuaja. Duke përdorur opsionin Partner Search ju do të keni mundësi të shihni kërkesat aktuale për partnerë të cilat publikohen zakonisht 1-2 muaj para se të mbyllet afati i aplikimit. Linku:

The screenshot shows the 'EU Funding & Tenders Portal' with the 'Partner search' section active. The search results are filtered by the 'Citizens, Equality, Rights and Values Programme (CERV)'. Two results are displayed:

Partner Name	Type	Projects	Partner search announcements
Aisté CAPIENÉ	Person	1	0
EXEO LAB S.R.L.	Organisation	0	92

[funding-tenders/partner-search](#)

Europe Goes Local - *Europe Goes Local* është një partneritet strategjik i zbatuar nga SALTO Youth dhe rrjeti i Qendrave Kombëtare Erasmus+ për Rininë dhe Korpusi Evropian i Solidaritetit. Ky program synon të forcojë punën rinore në nivel lokal në të gjithë Evropën, duke mbështetur bashkitë dhe organizatat lokale për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve për të rinjtë dhe për të nxitur pjesëmarrjen e tyre në komunitet. *Europe Goes Local* bashkon praktika të mira dhe ofron mjete për zhvillimin e politikave rinore në bashkëpunim me rrjete të ndryshme evropiane. Në seksionin Members tek linku me poshtë mund të gjeni partnerë nga shtete të ndryshme: **[Europe Goes Local](#)**



Qendrat Burimore SALTO janë struktura që ofrojnë mbështetje dhe burime për organizatat dhe individët që punojnë në fushën e rinisë në Evropë. SALTO (Support, Advanced Learning and Training Opportunities) ka disa qendra të specializuara në tema të ndryshme, përfshirë **përfshirjen sociale, pjesëmarrjen dhe qytetarinë aktive, mësimin ndërkulturor, mobilitetin rinor dhe solidaritetin evropian**. Qendrat SALTO ofrojnë trajnime, materiale edukative, udhëzime, dhe promovojnë praktikën më të mirë për të përmirësuar cilësinë e projekteve rinore në kuadrin e programit Erasmus+ dhe Korpusi Evropian i Solidaritetit. Qëllimi i tyre është të fuqizojnë rrjetin e organizatave rinore dhe të kontribuojnë në zhvillimin e politikave rinore në Evropë. Linku: [SALTO YOUTH](https://european-citizenship.eu/salto-youth)

Më poshtë gjeni një shembull udhëzues të cilin mund ta përdorni për kërkimin e partnerëve për projektin tuaj.

SALTO About SALTO Why? What? Where? When? Who?

Resource Centres Our activities and resources for you

Tools For European youth work and training

MySALTO Login to your personal SALTO dashboard

European Training Calendar

Atlas Partner-finding

Toolbox for Training Trainers Online for Youth

Call for Trainers

NEW QualityMobility.app

HOP online learning

SALTO Publications

SALTO & Evaluation

MOOC on Erasmus+

MOOC European Solidarity Corps

16599 organisations & informal groups

Finding partners for international projects has never been easier

Do you want to find new contacts in the world, send a volunteer missing partner for your project? No matter where your interests lie, you will find what you are looking for in Atlas.

Search for partners
Use our powerful search filters to find the perfect match in our database of more than 16500 organisations and informal groups.

Add your organisation or informal group
Register your organisation or informal group to demonstrate your interest in international cooperation.

Create projects and request partners
Millions of youth workers in organisations and informal groups around Europe will find your project and be able to cooperate with you.

Subjekti: Thirrje për Partnerë – Projekti i Binjakëzimit të Qyteteve, Programi CERV
Titulli i Projektit: [Titulli i Propozuar i Projektit]
Tema e Projektit: Binjakëzim Qytetesh për [Angazhim Qytetar, Përfshirje Sociale, Pjesëmarrje Demokratike, etj.]

Bashkia Drejtuese: [Emri i Bashkisë Suaj]

Afati i Aplikimit: [Afati Juaj për Përgjigjen e Partnerëve]

Përmbledhje e Projekt Idesë

Bashkia XY planifikon të aplikojë për projekt nën nismën e Binjakëzimit të Qyteteve të programit Qytetarët, Barazia, të Drejtat dhe Vlerat (CERV). Ky projekt synon të forcojë lidhjet midis qyteteve evropiane, të nxisë angazhimin qytetar dhe të promovojë vlerat Evropiane përmes të mësuarit të ndërsjellë dhe aktiviteteve të qytetarisë aktive. Ftojmë bashkitë, organizatat lokale dhe entitetet e shoqërisë civile të bashkohen me ne në këtë përpjekje bashkëpunuese për të forcuar lidhjet në komunitet dhe për të kontribuar në një Evropë më gjithëpërfshirëse dhe demokratike.

Objektivat e Projektit

- Të nxisim lidhjet dhe partneritetet midis qyteteve evropiane përmes shkëmbimeve kulturore dhe pjesëmarrjes qytetare.
- Të promovojmë kuptimin e vlerave të Bashkimit Evropian, si respekti për të drejtat e njeriut, demokracinë dhe kohezionin social.
- Të fuqizojmë qytetarët, veçanërisht të rinjtë, në vendimmarrjen lokale dhe përfshirjen në komunitet.
- Të rrisim ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e qytetarisë aktive dhe përfitimet e integritetit dhe bashkëpunimit në BE.

Aktivitetet e Propozuara:

- **Vizita Shkëmbimi:** Vizita ndërvepruese midis qyteteve partnere, me fokus në mësimin e përbashkët dhe shkëmbimin kulturor.
- **Workshope dhe Seminare:** Diskutime mbi angazhimin qytetar, edukimin dixhital dhe përfshirjen sociale.
- **Aktivitete për Angazhimin e Rinisë:** Aktivitetet që përfshijnë të rinjtë lokalë në planifikimin e qytetit, projekte komunitare dhe ngjarje me temë BE-në.

Kush mund të aplikojë për të qenë partneri ynë?

Ne jemi në kërkim të bashkive, organizatave jofitimprurëse, institucioneve të qeverisjes lokale dhe organizatave të shoqërisë civile të interesuara për pjesëmarrje aktive në projekt. Eksperienca e mëparshme në projekte të BE-së është e mirëpritur, por jo e nevojshme.

Përfitimet për Partnerët

- Angazhim me organizata të ngjashme në të gjithë Evropën për promovimin e vlerave të BE-së.
- Forcimi i rrjeteve lokale dhe rritja e vizibilitetit në komunitetin e BE-së.

- Përfitimi nga mundësitë për ndërtimin e kapaciteteve dhe ndarja e praktikave të mira.

Si të aplikoni?

Organizatat e interesuara duhet të dërgojnë një shprehje interesi, që përfshin:

- Një përshkrim të shkurtër të organizatës suaj dhe përvojës përkatëse.
- Motivimin tuaj për t'u bashkuar me këtë projekt të Binjakëzimit të Qyteteve.
- Informacionin e kontaktit për personin përgjegjës të projektit.

Ju lutemi dërgoni shprehjen tuaj të interesit deri më [Vendosni Datën e Afatit] në [Email-i Juaj i Kontaktit]. Ne ju mirëpresim të ndërtojmë një partneritet të suksesshëm që do të ndikojë pozitivisht në komunitetet tona dhe do të forcojë lidhjet në të gjithë Evropën.

Kontaktet për më shumë informacion

Për pyetje ose detaje të mëtejshme, mos hezitoni të na kontaktoni:

Email: [Email-i Juaj i Kontaktit]

Telefon: [Numri Juaj i Telefonit]

Adresa: [Adresa e Bashkisë Suaj]

Faleminderit për interesin dhe presim të dëgjojmë nga ju!

6. SI TË DORËZONI NJË APLIKIM

Të gjitha propozimet duhet të dorëzohen direkt online përmes Portalit të Financimit & Tenderave (Funding & Tenders Portal) në Sistemin e Dorëzimit Elektronik. **Aplikimet të printuara në letër NUK pranohen.**

Dorëzimi është një proces me 2 Hapa:

a) Hyni në këtë link Funding & Tender Portal dhe vendosni emailin dhe fjalëkalimin e lidhur me numrin tuaj PIC. Pasi keni hyrë në Portal, zgjidhni FUNDING (në të majtë në krye të faqes) dhe më pas shkoni tek CALLS for Proposals, zgjidhni programin CERV dhe thirrjen në të cilën dëshironi të aplikoni, për shembull CERV-2025-CITIZENS-TOWN-TT — Town-Twinning.

b) Dorëzoni propozimin

Pasi keni perzgjedhur thirrjen përkatëse në sistem, shikoni thirrjen dhe klikoni tek START the Submission. Dorëzoni propozimin tuaj të shkruar që ndahet në 4 pjesë, si më poshtë:

- **Pjesa A** përfshin informacion administrativ mbi organizatat aplikante (koordinatorin e ardhshëm, përfituesit, entitetet e lidhura dhe partnerët e shoqëruar) dhe buxhetin e përmbledhur për propozimin. **Plotësojeni direkt online.**

- **Pjesa B** (përshkrimi i projektit) mbulon përmbajtjen teknike të propozimit. Shkarkoni modelin e detyrueshëm në format Word nga Sistemi i Dorëzimit, plotësojeni dhe ngarkojeni si skedar **PDF**.
- **Pjesa C** përmban të dhëna shtesë të projektit. **Plotësojeni direkt online**.
- **Anekset**, ngarkoni dokumentat në format PDF/Excel (Dokumentin Excel të buxhetit, listen e projekteve apo dokumente të tjera të kërkuara sipas thirrjes përkatëse).

Këtu mund të gjeni një shembull në PDF të përmbajtjes së apikimit [af_cerv-og_en.pdf](#)

Ndërsa këtu gjeni udhëzuesin në gjuhën Angleze, se si të bëni një aplikim <https://webgate.ec.europa.eu/funding-tenders-opportunities/pages/viewpage.action?pageId=1867927>

7. SHEMBUJ FRYMËZUES

Në këtë link mund të lexoni dhe të eksploroni shembuj projektesh të suksesshme [Stories of project beneficiaries](#) dhe shembuj të tjerë të përfunduar. [CERV EU Funded projects](#).



BASHKITË PËR NË EVROPË
Një projekt i financuar nga BE

**Qytetarët, Barazia,
të Drejtat dhe Vlerat**

**RRUGËTIM NË
PROGRAMIN
CERV**

**SI PËRFITOJNË
BASHKITË?**